




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

K Ë R K E S Ë

DREJTUAR:

ZOTIT GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

KËRKUES:

MË SHUMË SE 1/4 E TË GJITHË DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ANËTARË TË GRUPEVE PARLAMENTARE TË OPOZITËS

OBJEKTI:

Krijimi i një Komisioni Hetimor të Kuvendit, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të organeve të pushtetit legjislativ apo ekzekutiv në kultivimin dhe trafikun e lëndëve narkotike, gjatë periudhës 1 Janar 2014 – 1 Janar 2018, përfshirë çështjen për të cilën akuzohet ish Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri, ndërhyrjeve të këtyre pushteteve në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organi i prokurorisë në hetimin penal të këtij rasti, si dhe efektet që kanë ardhur nga kjo ndërhyrje e paligjshme.

BAZA LIGJORE:

Nenet 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”; si dhe neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Z. Ruçi,

Gjatë muajit Tetor 2017, opinion publik u njoh me provat e qarta që provuan përfshirjen e zyrtarëve më të lartë të shtetit, përfshirë ish-Ministrin e Brendshëm, në veprimtari të paligjshme dhe kriminale, të lehtësimit dhe mbështetjes së organizatave kriminale në kryerjen e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Opozita në një betejë më shumë se 3 vjeçare, ngriti shqetësimin madhor të shndërrimit të Shqipërisë në një vend të kultivimit masiv të lëndëve narkotike. Qeveria, në papërgjegjshmëri të plotë, sulmonte opozitën dhe deklaronte se faktet e paraqitura prej saj, ishin të pavërteta dhe se në Shqipëri nuk ekzistonte fenomeni i kultivimit masiv të lëndëve narkotike. Vetëm në momentin kur partnerët ndërkombëtarë ngritën

shqetësimin madhor se sasi të paprecedentë të kanabisit po arrinin të deportonin në territoret e tyre nga Shqipëria, Qeveria pranoi ekzistencën e fenomenit dhe deklaroi se ajo nuk ishte e përfshirë në të, dhe se po merrte masa për të zgjidhur situatën.

Mirëpo, shqiptarët ishin dëshmitarë të fakteve sesi ish-Ministri i Brendshëm, jo vetëm përfitonte shpërblime monetare dhe dhurata nga grupet kriminale të trafikut ndërkombëtar të drogës, por gjithashtu këta të fundit përdornin makinën që ishte në emër të Ministrit të Brendshëm për të kryer trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

Për këtë qëllim, organi i prokurorisë, nisur edhe nga provat e siguruar nëpërmjet bashkëpunimit me prokurorinë italiane, kanë nisur hetim penal ndaj ish-Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri. Qeveria dhe mazhoranca po bëjnë gjithçka për të ndërhyrë në këtë hetim penal dhe për të penguar organin e prokurorisë në hetimin e pavarur të kësaj çështje. Për pasojë, është e nevojshme krijimin e një Komisioni Hetimor, për të vlerësuar këtë çështje, arsyet e ndërhyrjes dhe shkallën e kësaj ndërhyrje, me qëllim marrjen e masave për të lejuar hetimin e pavarur nga ana e organit të prokurorisë.

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 19.10.2017 është vënë në lëvizje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo e fundit, me shkresën nr. 9906 prot., datë 19.10.2017, ka kërkuar nga Kuvendi, dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Saimir Tahiri, si dhe për kontrollin personal dhe të banesës së tij. Kjo kërkesë e prokurorisë shoqërohet nga relacioni përkatës i arsyetuar, si dhe me provat e plota të administruara në seancën publike dhe jo publike të Këshillit, me anë të të cilit parashtrohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në datën 17.10.2017 ka regjistruar procedimin penal nr. 313, të vitit 2017 në ngarkim të deputetit Saimir Tahiri për kryerjen e dy veprave penale të mëposhtme:

- (i) Trafikimi i narkotikëve, të kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal;
- (ii) Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Me urdhrin nr. 2, datë 19.10.2017, Kryetari i Kuvendit thirri mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (këtu e në vijim Këshilli për Imunitetin), duke caktuar datën 20.10.2017, ora 11.00. Këshilli për Imunitetin zhvilloi dy mbledhje në datën 20.10.2017 dhe 21.10.2017.

Në mbledhje u shqyrtua kërkesa dhe relacioni i arsyetuar i prokurorisë, u konsultuan aktet provuese të mbledhura nga organi i prokurorisë, u dëgjuan përgjigjet e pyetjeve drejtuar tre prokurorëve që përfaqësonin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si dhe u dëgjua deputeti Saimir Tahiri dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij.

Faktet e grumbulluara nga organi i prokurorisë u bënë të njohura nëpërmjet medias dhe patën jehonë të gjerë në opinionin publik në Shqipëri. I gjithë opinionin publik, përmes transmetimit

mediatik të akteve hetimore (kryesisht atyre italiane), ra në dijeni për një organizatë kriminale me më shumë se 20 anëtarë, shtetas italiane, shtetas shqiptarë (mes të cilëve dhe familjarët Habilaj), që për të paktën 4 vjet kishin zhvilluar qetësisht trafikun ndërkombëtar të drogës, për bisedat midis familjarëve Habilaj dhe anëtarëve të grupit të strukturuar kriminal, që dëshmonin për kontakte të shpeshta me deputetin Saimir Tahiri dhe për lidhje të ngushta me të, gjer tek dhënia e dhuratave dhe e shpërblimeve të paligjshme, për vehtën, familjarët dhe partinë politike të tij që t'i përdorte për zgjedhje, si pasojë e krijimit prej tij të mbështetjes dhe lehtësimit për trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve.

Organet hetimore kanë zbuluar se shtetasi Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij, apo anëtarë të tjerë të organizatës kriminale, kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë, një prej të cilëve është edhe deputeti Saimir Tahiri, gjatë ushtrimit të funksionit të lartë zyrtar të Ministrit të Brendshëm. Vllezërit Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tyre kanë patur lidhje të ngushta me deputetin Saimir Tahiri dhe duke përfituar nga këto lidhje të ngushta dhe përmes shpërblimeve, kanë arritur të bëjnë të mundur, krijimin e kushteve për kultivimin në sasi të konsiderueshme të lëndës narkotike në Shqipëri, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë shtetit, me skafe, peshkarexha dhe automjete, ndër të tjera makina Audi me targë AA003GB. Deputeti Saimir Tahiri, gjatë ushtrimit të funksionit të Ministrit të Brendshëm, dyshohet se ka patur dijeni për këto fakte penale dhe se ka vepruar aktivisht për lehtësimin dhe mbështetjen e këtij aktiviteti të organizuar kriminal.

Deputeti Saimir Tahiri ka siguruar paprekshmërinë e grupit të strukturuar kriminal. E gjithë veprimtaria kriminale mbështetej në bashkëpunimin e grupit të strukturuar kriminal, me strukturat e policisë së shtetit, kryesisht ato të Drejtorisë së Qarkut Vlorë, por jo vetëm. Ky bashkëpunim është realizuar, nisur nga fakti se deputeti Saimir Tahiri, kontrollonte dhe drejtonte shërbimet e policisë së Shtetit, për shkak të funksionit që ushtronte në atë kohë, pikërisht atë të Ministrit të Brendshëm. Për shkak të ushtrimit të kësaj veprimtarie kriminale të trafikimit ndërkombëtarisht të lëndëve narkotike prej familjarëve Habilaj, kombinuar me krijimin e mbështetjes dhe lehtësirave ndaj tyre, prej deputetit Saimir Tahiri në funksionin e Ministrit të Brendshëm, deri tek fikja e radarëve të monitorimit të hapësirës detare, përfitime direkte monetare dhe dhurata të kushtueshme shkonin prej familjarëve Habilaj tek deputeti Saimir Tahiri.

Deputeti Saimir Tahiri në datën 05.11.2013, pasi kishte marrë detyrën e Ministrit të Brendshëm, deklaroi se e ka shitur automjetin e tij të markës Audi, me targë AA003GB tek i hetuari Artan Habilaj. Ky automjet rezulton të jetë përdorur disa herë më pas nga anëtarët e grupit të strukturuar kriminal. Kështu, vetëm 10 muaj më vonë, ky automjet rezulton të jetë përdorur 4 herë në muajin Gusht 2014 (në datat 8, 16, 29 dhe 30 gusht 2014) për hyrje-dalje nga territori i Shqipërisë nga Saimir Tahiri. Të dhënat hetimore tregojnë se edhe vetë deputeti Saimir Tahiri, e ka përdorur këtë automjet për të kaluar kufirin e territorit të Shqipërisë, pasi e kishte shitur atë. Është e qartë, që ky automjet ka shërbyer si mjet mbrojtës për grupin e strukturuar kriminal në kryerjen e trafikimit ndërkombëtar të narkotikëve. Sipas provave të përcjella nga prokuroria, prej rreth 1800 faqe, ku janë përkthyer pjesë relevante (procesi vazhdon), makina është blerë me qëllim lehtësimin e trafikut të drogës dhe armëve pasi ishte në emër të Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri.

Përgjatë gjithë kohës që deputeti Saimir Tahiri ka ushtruar funksionin e Ministrit të Brendshëm, Policia e Shtetit nuk ka kryer asnjë veprim pengues apo zbulues të veprimtarisë kriminale të familjes Habilaj dhe klanit të tyre – asnjë referim i veprave penale nuk është paraqitur nga policia e shtetit tek prokurori për grupin e strukturuar kriminal të Habilajve, sa kohë Ministër i Brendshëm ishte Saimir Tahiri. Policia e Shtetit, jo vetëm që nuk ka vepruar me nismën e saj, por edhe pse ka patur sinjalizime dhe informacione për veprimet hetimore që kryenin autoritetet italiane, si dhe informacione nga Agjencitë e tjera Ligjzbatuese në Shqipëri. Një prej këtyre informacioneve mbi aktivitetin kriminal të familjes Habilaj dhe klanit të tyre është paraqitur edhe nga SHISH, që sipas ligjit i ka shkuar jo vetëm Policisë së Shtetit, por edhe vetë Ministrit të Brendshëm, në cilësinë e drejtuesit të Shërbimit të Kontrollit të Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Brendshme. Nga ana tjetër, informacion i plotë u dha edhe nga një ish drejtues i Policisë së Shtetit Dritan Zagani, i cili përcolli informacion mbi aktivitetin kriminal të Habilajve, por në vend që të dëgjohej dhe mbështetej nga Ministri i Brendshëm, u largua nga puna dhe u detyrua të kërkojë mbrojtje për jetën e tij jashtë Shqipërisë. Ky mosveprim i Policisë së Shtetit është i qëllimshëm, hierarkikisht i imponuar, e për pasojë është edhe një tregues i qartë i përfshirjes së deputetit Saimir Tahiri në veprimtarinë kriminale të grupit të strukturuar, siç vërtetohet edhe nga pjesë relevante të dosjes hetimore të përkthyer dhe ato që janë në proces.

Mirëpo, pavarësisht fakteve të mësipërme, të shoqëruar me provat përkatëse nga organi i prokurorisë, mazhoranca në Këshill, dhe më pas në seancë plenare vendosi mosmiratimin për dhënien e autorizimit për “Arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesave të deputetit Saimir Tahiri”.

Ky përbën një akt të paprecedent në praktikën parlamentare shqiptare, ku nga organi i prokurorisë ngrihet një akuzë e rëndë penale ndaj një deputeti, dhe shumica parlamentare pengon prokurorinë të përdorë të gjitha mekanizmat e duhura ligjor, përfshirë dhënien e masave shtrënguese ndaj personit. Kjo çimenton kulturën e pandëshkueshmërisë në Shqipëri, dhe nuk ndihmon në proceset integruese të vendit. Ky fakt provon jo vetëm paligjshmërinë nga ana e mazhorancës, por gjithashtu, vullnetin e saj për të ndërhyrë dhe penguar hetimin penal ndaj këtij rasti.

Këtij konkluzioni i vjen në mbështetje edhe veprimet e Kryeministrit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave, të cilët në deklaratat publike dhe të njohura, jo vetëm kanë kritikuar organin e prokurorisë, por kanë përdorur ndaj tyre një gjuhë të papërshtatshme dhe intimiduese. Kjo sjellje bie ndesh me parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Por gjithashtu, tregon qartë se Kryeministri nuk shqetësohet vetëm për fatin e ish-Ministrit të Brendshëm, por për fatin e tij. Është e qartë se Kryeministri ka patur informacione të plota për veprimtarinë e grupeve kriminale në fushën e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, apo për përfshirjen e punonjësve të lartë të Policisë së Shtetit në këtë veprimtari kriminale. Megjithatë, nuk rezulton nga faktet dhe provat që disponohen nga ana jonë që të ketë marrë ndonjë masë mbi këtë fenomen, apo të ketë ushtruar përgjegjësitë e veta kushtetuese si Kryeministër i vendit dhe autoritet përgjegjës për të mbikëqyrur veprimtarinë e ministrave të tij.

Kryeministri i kapur nën përgjegjësi për këtë çështje, dhe i shqetësuar për fatin e tij, ndërmoi një akt të paprecedentë, duke emëruar, vetëm me 69 vota, pa ligj, dhe në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, një Prokuror të Përgjithshëm me mandat të përkohshëm, me qëllimin e vetëm të ndikimit mbi këtë çështje. Efektet e para të këtij veprimi tregojnë se ndërhyrja filloi të prodhonte efektet e para, për shkak se menjëherë pas emërimit, rezultoi se ish Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri iu hoq masa shtrënguese e ndalimit të daljes jashtë shtetit (arrestimi i tij u ndalua nga Partia Socialiste në Kuvend), ndërkohë u lirua shtetasi Orest Sota, i dyshuari për pastrim të parave të paligjshme të z. Tahiri dhe që ishte arrestuar në flagrancë me një shumë të konsiderueshme parash, ku gjendeshin edhe dy patenta lundrimi të ish Ministrit Saimir Tahiri.

Veprimet e paligjshme për të dëmtuar këtë çështje vijuan edhe më tej. Në kundërshtim flagrant me ligjin, është lejuar ekstradimi në Itali i shtetasit Nezar Seiti, i cili ishte personi i vetëm i arrestuar dhe në dispozicion të prokurorisë shqiptare në dosjen hetimore ndaj ish-Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Nga dokumentacioni që disponojmë rezultoi se ky shtetas ka qenë i ndaluar dhe nën procedim penal nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda të Shkallës së Parë, si pjesëtar i grupit të strukturuar kriminal “Habilaj”. Konkretisht, ky shtetas ka qenë subjekt i procedimit penal, në të njëjtën çështje me ish-Ministrin e Brendshëm dhe deputetin e mazhorancës Saimir Tahiri, me nr. 134 e vitit 2016, nr. 164 e vitit 2017 dhe nr. 313 e vitit 2017. Informacioni i mësipërm ka qenë në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë (përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve) dhe Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit).

Referuar nenit 8 të Konventës Europiane për Ekstradimin, ku theksohet se: “Një Palë e kërkuar mund ta refuzojë ekstradimin që kërkohet për një person, kur ky bëhet objekt ndjekjeje prej saj për një ose më shumë vepra për të cilat kërkohet ekstradimi”, si dhe referuar nenit 491 të Kodit të Procedurës Penale, ku specifikohet se: “Nuk mund të jepet ekstradimi: c) kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri; ç) kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit”, Ministria e Drejtësisë do të duhej të kishte refuzuar ekstradimin, apo të kishte vendosur ekstradimin e shtyrë apo të përkohshëm.

Mirëpo, rezultoi se Ministri i Drejtësisë, në injorim flagrant të detyrimeve të tij ligjore, ka urdhëruar ekstradimin e shtetasit Nezar Seiti dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka bërë dorëzimin e tij për qëllime të ekstradimit dhe nxjerrjen jashtë territorit të këtij shtetasi, edhe pse ka patur në dosje vendimet e Gjykatës për Krime të Rënda për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest me burg”, për qëllime të procedimit penal në Shqipëri. Në këtë mënyrë, personi i vetëm i arrestuar dhe në dispozicion të autoriteteve të drejtësisë shqiptare, në kuadër të procedimit penal për grupin e strukturuar kriminal “Habilaj”, pjesë e së cilit dyshohet të jetë edhe ish-Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, aktualisht nuk është më në dispozicion të Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda.

Ky fakt mund të ketë efekt shkatërrues për procedimin penal që po kryen Prokuroria për Krime të Rënda në kuadër të grupit të strukturuar kriminal “Habilaj”, dhe për pasojë edhe mbi procedimin penal të nisur ndaj deputetit të mazhorancës dhe ish-Ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Injorimi që Ministri i Drejtësisë i ka bërë jo vetëm ligjit, por edhe autoritetit të organeve të drejtësisë shqiptare (Gjykatës për Krime të Rënda), është një akt i paprecedentë për drejtësinë në vend. Nëse Ministri i Drejtësisë ndërmerr veprime arbitrare dhe të kundërligjshme, me impakt

të drejtëpërdrejtë në prishjen apo dëmtimin e hetimeve penale në një çështje konkrete në vend, atëherë jemi përpara një krimi shtetëror, të padëgjuar më parë dhe që është bërë qëllimisht për të ndërhyrë në procedimin penal në ngarkim të deputetit të mazhorancës dhe ish-Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri.

Sqarimet ekstraligjore të Ministrit të Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj se ekstradimi është bërë për shkak se ky shtetas është më mirë që të procedohet në Itali, apo se, nëse nuk do ishte vendosur ekstradimi opozita do ta akuzonte se po i fshehin personin drejtësisë italiane, është jo vetëm qesharak dhe i papërgjegjshëm, por mbi të gjitha tregues se për Ministrin e Drejtësisë dhe Qeverinë nuk ka rëndësi përmbajtja e ligjit, por vlerësimi politik. Nga ana tjetër, ky reagim publik i Ministrit të Drejtësisë provon se ekstradimi i kundërligjshëm është bërë qëllimisht dhe bazuar në motive ekstraligjore dhe qartazi politike. Në një shtet të së drejtës, udhëheqës për veprimet e autoriteteve publike, është ligji dhe vetëm ligji. Në rastin konkret, ligji nuk lejon ekstradimin kur ndaj personit ka një procedim penal në Republikën e Shqipërisë. Kjo ndalesë në Konventë dhe ligj, nuk është as rastësi dhe as e paqëllimtë. Ndalesa është vendosur me qëllim garantimin e efikasitetit të procedimit penal të nisur ndaj një shtetasi. Shkelja e këtij ndalimi sjell efektin e kundërt të parashikimit ligjor dhe konkretisht prishjen apo dëmtimin e procedimit penal përkatës.

Të gjitha faktet e mësipërme, flasim për një veprimtari të koordinuar të autoriteteve publike për të mos lejuar hetimin e kësaj çështje. Të gjitha këto, bëjnë të domosdoshme që të realizohet nga Kuvendi i Shqipërisë një hetim i plotë administrativ, në mbrojtje të interesit publik dhe marrjen e masave për të lejuar hetimin e plotë dhe të gjithëanshëm të kësaj çështje nga organet përgjegjëse kushtetuese.

II. BAZUESHMËRIA LIGJORE E KËRKESËS

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “... institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare”, që realizohet “... në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila, duke i pasur të kufizuara mjetet, “mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues”. Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik e shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik. Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar.

Qëllimi i Komisionit Hetimor që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë, synon që të mbledh informacione të hollësishme mbi zbatimin e legjislationit në fuqi gjatë veprimeve administrative të organeve të pushtetit legjislativ apo ekzekutiv, ndërhyrjeve të këtyre pushteteve në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organi i prokurorisë, si dhe efektet që kanë ardhur nga kjo ndërhyrje e paligjshme, në rastin e hetimit penal ndaj ish Ministrit të

Brendshëm z. Saimir Tahiri. Nga ana tjetër, kërkohet të mblidhen informacione mbi veprimet apo mosveprimet e organeve shtetërore, ndaj fenomenit kriminal për të cilin po procedohet ish Ministri i Brendshëm, si dhe ushtrimin e përgjegjësisë shtetërore nga ana e tyre.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore kushtetuese, për shkak se nuk sjell konfondime dhe transferime kompetencash të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon njohjen dhe verifikimin në thellësi të fenomenit të bërë publik për ndërmarrjen e veprimeve aktive nga ana e Qeverisë dhe Parlamentit për të penguar hetimin e çështjes apo minizimin e rezultateve të saj, me qëllimin që në përputhje me realitetin, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit, apo korrigjimit të ligjeve të veçanta, apo marrjen e masave urgjente për mbrojtjen e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës. Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij hetimi parlamentar, kontrollohet edhe zbatimi i ligjeve, nxirret përgjegjësia mbi mënyrën e zbatimit të tij dhe bëhen rekomandimet përkatëse me qëllim parandalimin dhe eliminimin e mundësisë për të ndërhyrë në pavarësinë e një organi tjetër kushtetues dhe për të lejuar hetimin e plotë dhe të gjithëanshëm të kësaj çështje.

E drejta e hetimit do të realizohet vetëm, brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim, apo hulumtim të hollësishëm të kësaj çështjeje. Dobishmëria e këtij hetimi sigurisht që shihet në nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve, funksionimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e pavarësisë së organeve të drejtësisë.

Nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare, natyra e çështjeve të hetuara nga komisionet hetimore ka qenë e një rëndësie substanciale apo parësore për publikun, me ndikim të veçantë në marrëdhëniet ndërshtetërore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale dhe mospërsëritjen e fenomeneve të hetuara në të ardhmen. Në këtë drejtim, çështjet më të shumta kanë patur për objekt administrimin e fondeve publike, marrëdhëniet ndërshtetërore, falimentimet e korporatave apo subjekteve të ndryshme private, të cilët kanë patur impakt në ekonominë e vendit, apo hetimin e fenomeneve kriminale¹. Në rastin konkret, puna e Komisionit Hetimor nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësisë penale për personat e përfshirë në këtë fenomen negativ, pasi kjo është detyrë funksionale e organeve të drejtësisë. Komisioni Hetimor do të përqëndrojë punën e tij në njohjen dhe verifikimin në thellësi të ligjshmërisë së veprimeve administrative të organeve të pushtetit legjislativ apo ekzekutiv, ndërhyrjeve të këtyre pushteteve në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organi i prokurorisë, si dhe efektet që kanë ardhur nga kjo ndërhyrje e paligjshme, në rastin e hetimit penal ndaj ish Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri. Nga ana tjetër, kërkohet të mblidhen informacione mbi veprimet apo mosveprimet e organeve shtetërore, ndaj fenomenit kriminal për të cilin po procedohet ish Ministri i Brendshëm, si dhe ushtrimin e përgjegjësisë shtetërore nga ana e tyre, me qëllimin që në përputhje me realitetin, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit, apo korrigjimit të ligjeve të veçanta, si dhe parandalimin dhe eliminimin e këtij fenomeni negativ dhe përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, në përputhje të plotë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

¹ Vendimi nr. 18/2003 i Gjykatës Kushtetuese

Objekti i hetimit, është i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në kërkesë, si dhe përmban fakte të përcaktueshme, të cilat të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet, duke evidentuar edhe çështjen që kërkohet të hetohet. Nga faktet e disponuara nga ana jonë dhe që një pjesë janë bërë edhe publike në media, rezulton se ekziston një lidhje substanciale midis informacionit apo hetimit që kërkohet të realizohet, dhe një shkallë të arsyeshme të qëllimit legjitim të legjislativit, për mbrojtjen e parimeve të shtetit të së drejtës dhe çimentimin e kulturës së pandëshkueshmërisë në rradhët e zyrtarëve të lartë.

Ajo që mbetet për t'u vlerësuar/hetuar nga Komisioni Hetimor është mekanizimi konkret që po përdoret për të penguar hetimin, si dhe njohja dhe verifikimi i hollësishëm i situatës, me qëllim parandalimin e fenomenit të kundërligjshme në të ardhmen dhe ruajtjen e parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor, përmbush tre kriteret kushtetuese si më poshtë: 1) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2) objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete; si dhe 3) ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën praktikave që dëmtojnë hetimin penal të nisur dhe zbardhjen e të vërtetës mbi këtë çështje, për të cilën është i nevojshëm hetimi parlamentar.

Për pasojë, në funksion të mbrojtjes së Kushtetutës; parimeve të demokracisë funksionale dhe interesit publik; si dhe nisur nga rëndësia e jashtëzakonshme që ka kjo çështje edhe për proceset integruese të vendit; me synimin për ti vënë fre një herë e mirë praktikave abuzive dhe ndërhyrjes së institucioneve shtetërore në pavarësinë e organit të prokurorisë dhe hetimet konkrete të këtij organi; si dhe në kushtet kur jemi të bindur se përmasa reale e fenomenit është shumë herë më e madhe nga sa është deklaruar deri më tani; në përputhje me nenin 77 të Kushtetutës, ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”; si dhe nenin 25 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

KËRKOJMË:

Ngritjen e një Komisioni Hetimor, me:

Qëllim – “Kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të organeve të pushtetit legjislativ apo ekzekutiv në kultivimin dhe trafikun e lëndëve narkotike, gjatë periudhës 1 Janar 2014 – 1 Janar 2018, përfshirë çështjen për të cilën akuzohet ish Ministri i Brendshëm z. Saimir Tahiri, ndërhyrjeve të këtyre pushteteve në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organi i prokurorisë në hetimin penal të këtij rasti, si dhe efektet që kanë ardhur nga kjo ndërhyrje e paligjshme.

Objekti dhe çështjet kryesore që do të hetohen – (1) Roli, dijenia dhe përgjegjësia e Kryeministrit, anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore, veprimet apo mosveprimet e tyre, në parandalimin dhe ndëshkimin e fenomenit të kultivimit të kanabisit apo trafikimit të lëndëve narkotike; (2) Arsyet e veprimeve dhe sjelljes së Kryeministrit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave në intimidimin e organit të prokurorisë mbi çështjen për të cilën akuzohet ish Ministri i Brendshëm z. Saimir Tahiri; (3) Vlerësimi i rrethanave mbi dijeninë e Kryeministrit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit

të Ministrave për veprimtarinë kriminale apo ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre shtetërore në drejtim të parandalimit të paligjshmërisë për të cilën akuzohet ish-Ministri i Brendshëm dhe drejtues të lartë të Policisë së Shtetit; (4) verifikimi i ligjshmërisë dhe efekteve të vendimit administrativ të Kuvendit për pengimin e organit të prokurorisë që të kërkonte në gjykatë arrestimin e ish-Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri, si dhe nxjerrja e provave që përbëjnë sekret hetimor nga anëtarët e Këshillit; (5) veprimet dhe sjellja e Kryeministrit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave, si dhe e çdo zyrtari tjetër publik, në pengimin apo intimidimin e organit të prokurorisë që të veprojë në mënyrë të pavarur dhe paanshme në hetimin e çështjes penale ndaj ish Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri; (6) ndërhyrjet nga organet e pushtetit legjislativ apo ekzekutiv në hetimin e kësaj çështje, si dhe efektet që kanë sjellë këto ndërhyrje; (7) evidentimi i pengesave që ka hasur organi i prokurorisë në hetimin e këtij zyrtari të lartë, nga veprime apo mosveprime të paligjshme të organeve të tjera të administratës shtetërore; (8) ligjshmëria e ekstradimit të personit tjetër nën hetim për të njëjtën çështje dhe efektet që sjell ky ekstradim në ushtrimin e ndjekjes penale ndaj ish-Ministrit të Brendshëm; (9) rreziqet që paraqiten për hetimin e pavarur, të shpejtë, efikas dhe të gjithëanshëm të kësaj çështje, dhe mjetet që duhet të përdoren për të eliminuar në mënyrë kushtetuese dhe ligjore këto rreziqe; (10) vlerësimi mbi nevojat e organit të prokurorisë, për burime financiare dhe njerëzore, për hetimin e plotë, të pavarur dhe të paanshëm, të kësaj çështje, si dhe verifikimi nëse këto burime janë vënë në dispozicion.

Përbërje – 11 anëtar, nga ku kryetari dhe 3 anëtarë do të jenë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 anëtar do të jetë përfaqësues i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, dhe 6 anëtarë do të jenë përfaqësues të Grupeve Parlamentare të partive të mazhorancës parlamentare.

Afat të përfundimit të hetimeve – 3 muaj nga krijimi i Komisionit Hetimor.

Në këto rrethana, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit për ngritjen e Komisionit Hetimor, që i bashkëlidhet kësaj kërkesë. Gjithashtu, në mbështetje me nenin 7 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, kërkojmë nga ana juaj që sa më parë, por në çdo rast jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës, të mbledhni Konferencën e Kryetarëve për të diskutuar mbi këtë kërkesë, përbërjen e komisionit, si dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend në seancën plenare më të afërt.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT: 1- Edi Paloka
2- Flamur Nalaj
3- Isuf Cera
4- Xhevat Ahmeti
5- Xhevat Gjushaj
6- Genc Tella
7- Endri Hasa
8- Orel Islykashi
9- Izmira Ullinaku

Lucan Basi

11. LUCIANE BOSI

12 - Mylène Muvras

13. Dursun Çupri

14. Andon Firokaj

15. Lindita Metohaj

16. Borok Spahia

17/ Tita Sheh

18/ Aron Shetaj

19. ORJOLA PAMPURI

20. Nadire Hecorapaj

21. Fatbardha Kadri

22. Valente Duka

23. Hekuran Hekuran

24. Enam Solianji

25. Judo Tabela

26. Nalun K...

- 27- KLEVIS BALLIU ~~JS~~
- 28 Astrat Velig ~~g~~
- 29 Doshomi Fleke ~~JS~~
- 30 FIVECEPO AKIBET ~~JS~~
- 31 Vampje / Ink ~~JS~~
- 32 Nord Nidok ~~JS~~
- 33 Floppa (living) ~~JS~~
34. Schmechel Spate ~~JS~~
35. Aldo Berner ~~JS~~
36. Albans Vohl. ~~JS~~
37. Gent Shorimmi ~~JS~~



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

VENDIM

Nr. ____/2019

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR VEPRIMET DHE MOSVEPRIMET E ORGANEVE SHTETËRORE NË PARANDALIMIN DHE GODITJEN E FENOMENIT TË KULTIVIMIT DHE TRAFIKUT TË LËNDËVE NARKOTIKE, GJATË PERIUDHËS 1 JANAR 2014 – 1 JANAR 2018, PËRFSHIRË ÇËSHTJEN PËR TË CILËN PROKURORIA PO HETON Z. SAIMIR TAHIRI, ISH-MINISTËR I BRENDSHËM

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, gjatë periudhës 1 Janar 2014 – 1 Janar 2018, përfshirë çështjen për të cilën Prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm.

II. Verifikohet çdo lloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, në hetimin penal të këtij rasti.

III. Hetimi synon mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e organeve përgjegjëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë, si më poshtë:

- | | | |
|----------------------|---|------------------------------|
| 1. Edi Paloka | - | Kryetar (PD); |
| 2. _____ | - | Zëvendëskryetar/Anëtar (PS); |
| 3. Enkelejd Alibeaj | - | Anëtar (PD); |
| 4. Flamur Noka | - | Anëtar (PD); |
| 5. Myslym Murrizi | - | Anëtar (PD); |
| 6. Endrid Braimllari | - | Anëtar (LSI); |
| 7. _____ | - | Anëtar (PS); |
| 8. _____ | - | Anëtar (PS); |
| 9. _____ | - | Anëtar (PS); |
| 10. _____ | - | Anëtar (PS); |
| 11. _____ | - | Anëtar (PS). |

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VII. Komisioni administron dhe shqyrton të gjitha materialet e ardhura në zbatim të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 30/2018, pa qenë e nevojshme ripërsëritja e kërkesave për informacion për institucionet që kanë përmbushur përgjegjësinë e tyre ligjore.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhërave të kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më ____/____/2019.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI